REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**

**Nr. ______ Prot.** **KORÇË, më ___.___.2025**

# Relacion

## Projekt restaurimi

## "Restaurim i kishës së Shën Mëhillit, Vithkuq"





Adresa: Lagjia 11 Rruga Lefter Serafini, Korcë, Shqipëri, Tel.:082243122, E-mail info@drtkkorce.gov.al

# PERMBAJTJA

**1.VENDNDODHJA** ........ **3**

**2.ANALIZA HISTORIKO-ARKITEKTONIKE E MONUMENTIT** ........ **4**

2.1 Të dhëna historike ........ 4

2.2 Analiza arkitektonike ........ 4

2.3 Teknikat e konstruksionit ........ 7

**3.NDERHYRJET NDER VITE** ........ **8**

**4.DOKUMENTIMI FOTOGRAFIK DHE GRAFIK** ........ **9**

**5.GJENDJA E MONUMENTIT** ........ **14**

5.1 Dëmtimet dhe shkaqet ........ 15

5.2 Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese ........ 26

## 1.VENDNDODHJA

**Kategoria** : Monument Kulture i Kategorisë I

**Shpallur** : Me vendim të fundit NR. 1886-DT.10.06.1973 me institucion të shpalljes "Ministria e Kultures"

**Gjinia** : Objekt kulti

**Vendndodhja** : Fshati Vithkuq

Kisha e Shën Mëhillit ndodhet në fshatin Vithkuq të rrethit të Korcës. Ajo është ndërtuar në dalje të lagjes Krekas në një pllajë të vogël. Përpara kishës, në anën jugore hapet një shesh i gjerë, i rrethuar me mure, ndërsa nga ana veriore ndodhen varrezat e vjetra të fshatit.



Vendndodhja e Korçës — Vendndodhja e fshatit Vithkuq



Vendndodhja e kishës së Shën Mëhillit në raport me fshatin Vithkuq

## 2. ANALIZA HISTORIKO – ARKITEKTONIKE E MONUMENTIT

## 2.1. Të dhëna historike

Kisha e Shën Mëhillit është kisha më e vjetër dhe më e madhe që ruhet në Vithkuq, e cila për vlerat arkitektonike dhe artistike të pikturës murale të saj, është shpallur Monument Kulture. Ajo është ndërtuar në vitin 1672 dhe pikturuar në vitin 1728, kohë e cila përkon me periudhën kur Vithkuqi kishte marrë zhvillim si vendbanim. Në këtë kohë Vithkuqi kishte 24 lagje, 12 kisha e shumë objekte të tjera si mullinj, hane, ura, etj. Mbishkrimi mbi portën jugore të kishës daton ndërtimin e saj nga themelet më 1672 dhe pikturimin më 1728, me kontribute të krishterëve vendas dhe priftërinjve.



Foto Pamje e jashtme e Kishës

## 2.2. Analiza Arkitektonike

Përsa I përket tipit të bazilikave, kasha e Shën Mëhillit I përket bazilikave të mbuluara me sistem qemerësh. Prirjet për krijimin e një ambjenti sa më hapësinor dhe të lidhur që shfaqen në Kishën e Shën Mëhillit, arrijnë të kristalizohen dhe përsosen si koncept kompozicional në kishat e Voskopojës. Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati.




Plani I Kishës (Skicat referuar projektit të miratuar në vitin 2008)



Fasada Lindore (Skicat referuar projektit të miratuar në vitin 2008)



Fasada Jugore dhe Veriore (Skicat referuar projektit të miratuar në vitin 2008)

**Naosi** është i tipit bazilikal, trenefësh me përmasa të brendshme 15.5x9.5 m. Dy radhë kollonash ndajnë nefet nga njëri-tjetri, nga të cilët nefi qendror është më i gjerë dhe më i lartë nga dy anësorët. Kollonat lidhen ndërmjet tyre dhe me muret perimetrale me një sistem harqesh në të dy drejtimet. Në nefet anësore ky sistem harqesh ka krijuar bërthama katrore, të cilat mbulohen me kupola, ndërsa në nefin qendror shërben si brinjë rigjiditeti (qëndrueshmërie) të qemerit cilindrik që e mbulon atë gjatë gjithë gjatësisë së tij. Nefet gjatësore ndërpriten nga një nef tërthor, duke krijuar në pjesën qendrore një bërthamë të mbuluar me kupolë, e cila e fuqizon në mënyrë të ndjeshme hapësirën e brendshme. Megjithatë, kjo strukturë e larmishme qemeresh, kupolash e harqesh nuk shfaqet në pamjen e jashtme, por është e fshehur nga çatia e gjerë dyujëse. Në anën lindore del jashtë apsida, e cila është trajtuar me një varg pilastrash në qoshet e muraturës, të lidhura me harqe të shkallëzuara në formë fund lundre, dhe përfundon me një kornizë me gurë të gdhendur. Motivi i harkut fund-lundre takohet dhe në mbulesat e dritareve të hapura në murin lindor.

Muratura e kishës është e rregullt, e ndërtuar me blloqe të punuara guri çmërs.


Adresa: Lagjia 11 Rruga Lefter Serafini, Korcë, Shqipëri, Tel.:082243122, E-mail info@drtkkorce.gov.al

**Narteksi** është shtuar më vonë në anën perëndimore. Ai ndryshon nga naosi qoftë nga teknika e ndërtimit qoftë nga konceptimi i hapësirës së brendshme. Brenda narteksit ka një radhë kollonash guri dhe tjetrën prej druri, dhe mbulohet nga çatia prej druri, pa tavan.

**Hajati** i hapur zhvillohet gjatë gjithë anës jugore të kishës me një harkadë mbi kolona të holla guri. Është i mbuluar nga zgjatimi i flegrës së çatisë së naosit, gjë që e rrit akoma më tepër shtrirjen e saj. Megjithatë, harkada e lehtë dhe elegante e hajatit në pamjen jugore, e zbut përshtypjen e peshës dhe të masivitetit të flegrës tepër të gjerë të çatisë, të mbuluar me rrasa guri.

### 2.3. Teknikat e konstruksionit

**Muratura** e kishës është e rregullt, e ndërtuar me blloqe të punuara guri smërçi, i cili është lehtësisht i punueshëm.
**Çatia** është dy ujëse më perjashtim të fundit të anës lindore e perëndimore ku krijon një thyerje të vogël në raport me sipërfaqen e saj. Ajo është realizuar me konstruksion druri dhe mbuluar me plloça guri. Streha e saj është e ngushtë. Ndryshimi i lartësive të ambienteve të brendshme nuk reflektohet në thyerjen e çatisë.

KA ZONE TE MBROJTUR TE MIRATUAR
MINISTRIA E KULTURËS/NR.761/ DT.23.11.2017



## 3. NDËRHYRJET NDËR VITE

Nga të dhënat e arkivit të IMK rezulton se ka pasur disa ndërhyrje restauruese në vite në kishën e Shën Mëhillit, Vithkuq.

- Ndërhyrja e parë është bërë në vitin 1963, kohë e cila përkon me shpalljen monument kulture të kishës. Në relacionin e vitit 1980 dokumentohen ndërhyrjet restauruese të kryera ne vitin 1963, kryesisht vendosje tirantash druri, revizionim çatie etj. Nga fotot e arkivit në vitin 1967 kisha rezulton e restauruar me ndërhyrje të thella, krahasuar me fotot e vitit 1963.

- Në fotot e vitit 1975 kisha paraqitet afërsisht në të njëjtën gjendje me atë të vitit 1967, me ndryshimin që në çatinë e kishës në fotot e vitit 1967 çatia ka një baxha dhe në fotot e vitit 1975 ka 2 të tilla. Kjo tregon që në këtë periudhë ka pasur ndërhyrje të lehta restauruese.

- Në vitin 1977 në relacionin e mbajtur për gjendjen e kishës së Shën Mëhillit në Vithkuq, tregon hajati i kishës është mbyllur me materiale të lehta pa e prishur arkadën dhe përdorej për depo.

- Në vitin 1980 kisha është restauruar përsëri në fotot shihet se në çatinë e saj ka 3 baxha.

- Në vitin 2008 kisha përsëri është restauruar. Muri verior dhe perëndimor i narteksit është restauruar, çatia e naosit, etj. Në muret e restauruar nuk janë vendosur brezat e drurit, është përdorur cimento ne llacin e murit.

- Në vitin 2014 është bërë ndërhyrje restauruese në çatinë e naosit dhe narteksit. Restaurimi përfshin zbulim çatie, ndërrim i lëndës së drurit të degraduar, vendosje shtrese hidroizoluese dhe mbulim me rrasa guri.

- Në vitin 2019 kishës I është bërë ndërhyrje restauruese në çatinë e hajtit dhe I portës hyrëse.

- Në vitin 2021 është bërë ndërhyrje restauruese në çatinë e

Në të gjitha ndërhyrjet restauruese te viteve te kaluara dokumentacioni i shkruar nuk është i plotë me përjashtim të atij fotografik.

## 4. DOKUMENTIMI FOTOGRAFIK DHE GRAFIK



























Foto të gjendjes ekzistuese eksterier








Foto të gjendjes ekzistuese interier

## 5. GJENDJA E MONUMENTIT




Plansistemimi

### 5.1. Dëmtimet dhe shkaqet

Kisha e Shën Mëhillit Vithkuq është një ndër kishat e cila ka nevojë për restaurim dhe për këtë është realizuar projekti i restaurimit i plotë për të gjithë objektin i hartuar nga DRTK Korçë. Sipas dokumentacionit grafik dëmtimet në kishën e Shën Mëhillitt kanë ardhur si pasojë e kushteve atmosferike, pranisë së lagështirës, mungesa e shtresës hidroizoluese dhe dëmtimi I rrasave të gurit, si dhe nga amortizimi ndër vite. Gjendja e saj paraqitet jo e mirë, nga ku kemi evidentuar dëmtimet dhe ndërhyrjet, bashkangjitur dhe me fotot ilustruese.

FAKTORET E PROBLEMATIKAVE KRYESORE NE OBJEKT

**1. DEMTIM I RRASAVE TE GURIT**
***FAKTORET :*** *- KUSHTET KLIMATERIKE - KUSHTET ATMOSFERIKE*




**2. DEMTIM I PJESSHEM I ELEMENTEVE DRUSORE**

***FAKTORET :*** *- LAGESHTIA PER SHKAK TE DEPERTIMIT TE UJERAVE SIPERFAQESORE*
*- MUNGESA E SHTRESES HIDROIZOLUESE NE CATI*
*- DEMTIM I RRASAVE TE GURIT*




Siç dhe është paraqitur në skicën më lart, në kishë do të kemi ndërhyrje kryesore në pjesën e çatisë, ku pjesa e naosit do të ketë restaurim të çatisë. Në këtë pjesë të kishës, e cila është pjesa qëndrore e saj vihen re plasaritje të harqeve të kollonave, si dhe të disa kupolave. Plasaritjet e mëparshme dallohen si nga vjetërsia, ashtu edhe nga ndërhyrja që është bërë për restaurimin e tyre. Restaurimi I tyre është domosdoshmëri për konsolidimin e elmentëve konstruktivë, si në mure, harqe dhe kupola. Bazuar në projektin e miratuar me datë 26/07/2017dhe fotot aktuale, vërehen se çarjet dhe plasaritjet kanë pësuar ndryshime, duke u

krijuar çarje më të mëdha në disa kupola dhe harqe edhe në vendet ku është bërë ndërhyrje, sipas fotove krahasuese më poshtë.



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025



Adresa: Lagjia 11 Rruga Lefter Serafini, Korcë, Shqipëri, Tel.:082243122, E-mail info@drtkkorce.gov.al



Foto projekti I miratuar 2017



Foto 2025

Pjesa e narteksit është pjesë e kishës, e cila ndryshe nga naosi nuk ka tavan dhe mbulesa është çati druri me plloça. Restaurimi I saj është kryer në vitet e fundit, përkatësisht në vitin 2019. Në projektin e propozuar, në këtë hapësirë të çatisë do të kemi qeramosje.

Gjithashtu, qeramosje do të kemi dhe në pjesën e hajatit. Vlen të përmendet ndërhyrja në muraturën e kishës përmes fugatimit, si dhe ndërhyrja në murin rrethues.

**Dëmtimet janë :**

- Muraturë në të gjithë perimetrin e objektit me prani bimësie të ulët
- Rënie e murit të gurit rrethues dhe mungesë e kreut të murit
- Depërtim I lagështirë në kupolë
- Mungesë dhe dëmtim I shtresës hidroizoluese
- Dëmtim I petavrave të drurit
- Rrasa guri të dëmtuara
- Dëmtim fugature
- Tiranta kanë nevojë për trajtim
- Harqe dhe qemerë të dëmtuar (plasaritje dhe çarje)
- Kunetë e dëmtuar

**5.2. Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese**

**Ndërhyrjet e propozuara janë :**

- Pastrim I mureve nga bimësia

*Pastrime bimësie përfshin pastrimin e bimësisë spontane në pjesën e fasadës së kishës, si dhe në murin rrethues.*

- Shtim I murit rrethues dhe konsolidim I kreut të murit

*Muri rrethues ka pësuar dëmtime dhe rrëzim të gurëve dhe për këtë arsye do të bëhet sistemim, shtim I rreshtave me gur, duke mos penguar kontaktin e plotë visual me kishën. Gjithashtu, do të bëhet konsolidimi I kreut të murit. Këto ndërhyrje do të jenë në anën jugore dhe lindore.*

- Qeramosje e catisë me rrasa guri (zbulim, mbulim çatie plotësime me rrasa guri dhe restaurim petavrash)

*Prania e lagështisë dhe amortizimi vërehen në narteksin dhe hajatin e catisë së kishës, duke sjellë dëmtimin e shtresës hidroizoluese, dëmtimin e konstruksionit të drurit, si dhe rrasave të gurit. Mbulesa e catisë është e përbërë nga shtresa e rrasave të gurit, shtresë hidroizoluese dhe petavra druri, nga ku është I nevojshëm zëvendësimi I tyre dhe restaurimi.*


Adresa: Lagjia 11 Rruga Lefter Serafini, Korcë, Shqipëri, Tel.:082243122, E-mail info@drtkkorce.gov.al

- Zëvendësimi dhe vendosja e shtresës hidroizoluese

*Prania e lagështisë në hapësirën e brendshme të kishës është favorizuar dhe nga dëmtimi I shtresës hidroizoluese apo nga mungesa e saj. Për të shmangur degradimin akoma më të madh të elementëve përbërës të saj, do të bëhët ndërhyrje në të gjithë sipërfaqen e çatisë përmes vendosjes së shtresës së hidroizolimit.*

- Pastrim murature nga mbushja dhe llaçi I degraduar dhe fugatim I tyre

*Muratura është e ndërtuar me blloqe gur, ku vërehet prania e bimësisë dhe e papastërtive në eksterier të kishës. Shfaqet nevoja e pastrimit të tyre. Në pjesë të caktuara të eksterierit të kishës dëmtime të fugaturës, ku në varësi të problematikës do të bëhet dhe ndërhyrja.*

- Trajtim me lyerje të tiranteve të dëmtuar

*Tirantat e drurit janë të vendosura në pjesën e hajatit të kishës, të cilat kanë nevojë për trajtim dhe lyerje.*

- Restaurim I çatisë me rrasa guri

*Mungesa e shtresës hidroizoluese, dëmtimi I rrasave të gurit, si dhe faktori kohë, ka mundësuar degradimin e çatisë në pjesën e naosit dhe kërkon ndërhyrjen e plotë të elementëve të saj.*

- Pastrimi I qemerëve dhe kupolave nga mbushja dhe llaçi I degraduar dhe restaurimi I tyre

*Në pjesën e naosit dhe hajatit, shfaqen dëmtime të mëdha, të cilat kanë ardh nga teknika jo e mirë e fugatimit të kryer ndër vite. Me ndërhyrjen e propozuara, është propozuar pastrimi I tyre nga mbushja dhe llaçi I degraduar tashmë dhe restaurimi përmes teknika të duhura.*

- Konsolidim strukturor I muraturave prej guri

*Kjo ndërhyrje në muraturën prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes) do të kryhet me teknikën e injektimit dhe realizimi I tyre do të bëhet në prani të restauratorit të pikturës murale.*

- Fugatim në elementët e dëmtuar, injektim në rastin e carjeve më të thella, qepje me shufra inoksi

*Siç u theksua dhe më lart, pas pastrimit të muraturës do të bëhet dhe ndërhyrja e duhur, si psh. me teknikën e injektimit dhe* ***qepje konstruksioni me shufra inoksi nësë do të shikohet nevoja gjatë zbatimit.***

- Ndërtim qemeri (plotësim qemeri dytësor mbi çati)

*Në këtë projekt është propozuar plotësimi I qemerit dytësor në vendet ku do të jetë e nevojshme ndërhyrja,* ***por gjatë zbatimit të projektit dhe hapjes së çatisë do të vendoset për ndërhyrjen në të, nëse është ndërhyrje e mëvonshme apo tipologji e objektit.***

- Gërmim dhe shtrim me pllakë guri për kunetën

*Aktualisht, kuneta është e dëmtuar dhe nevojitet ndërhyrje për pastrimin dhe shtrimin e saj me pllaka guri.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**

NDERHYRJET NE MURIN RRETHUES

GJENDJA EKZISTUESE

SKENA





FOTO 1



FOTO 2



FOTO 3



FOTO 4

NDERHYRJET NE MURIN RRETHUES

MONTAZH

SKEMA





FOTO 1



FOTO 2



FOTO 3



FOTO 4

NDERHYRJET NE MURIN RRETHUES

PAMJA PERENDIMORE




PAMJA JUGORE



DETAJE TE CATISE/ KUNETES

FOTO TE ARKIVES



DETAJ I QEMERIT




DETAJ I CATISE




DETAJ I KUNETES




Relatoi :

Ark. Bruna Arkaxhiu

Ing.Xhuljana Avdolli

Xhuljana Avdolli
Digitally signed by Xhuljana Avdolli
Date: 2025.05.06 12:52:54 +02'00'